



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

ODA E STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14, nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.16 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, si dhe nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe nenit 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Statutit të OSK-së, bazuar në kërkesat individuale të anëtarëve të OSK-së dhe të institucioneve publike shëndetësore (QKMF) nga qytete të ndryshme, përmes Zyrës Ligjore të saj dhe me qëllim të dhënies së një sqarimi të përgjithshëm mbi çështjen, me datë 25.08.2025, nxjerr këtë:

OPINION LIGJOR

**MBI TË DREJTËN E DOKTORËVE TË STOMATOLOGJISË TË LICENCUAR NË
PROFILE SPECIALISTIKE PËR TË USHTRUAR PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E
DOKTORIT TË STOMATOLOGJISË**

I. Qëllimi

Ky opinion ka për qëllim të shërbejë si dokument orientues dhe referencë zyrtare për institucionet publike shëndetësore, duke siguruar interpretim të qartë dhe trajtim të barabartë të anëtarëve të OSK-së, përfshirë ata me profile specialistike, gjatë procedurave të rekrutimit për pozitën e doktorit të stomatologjisë.

II. Baza ligjore mbi nxjerrjen e përfundimeve të opinionit

1. Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, neni 72, përcaktohet se "Profesionisti i licencuar shëndetësor ka të drejtë të aftësohet në lëmi të ndryshme të kujdesit shëndetësor nëpërmjet shkollimit specialistik pas-diplomik – specializimit." Ky nen lë të kuptohet se licenca bazë e profesionistit është ajo e doktorit të stomatologjisë dhe, rrjedhimisht, licencimi si doktor i stomatologjisë është parakusht për specializim.

2. UA nr. 01/2023 për shkollim specialistik, – neni 18, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.2 "Për specializimet e doktorëve të stomatologjisë duhet të kenë mbaruar fakultetin e stomatologjisë", nënkupton të njëjtën gjë, sikurse është përcaktuar edhe me nën paragrafin 1.5 të të njëjtit nen, ku kandidati duhet të ketë licencën profesionale të doktorit të stomatologjisë si kusht për të fituar shkollimin specialistik.
3. Rregullorja e OSK-së për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin, nr. prot. 3116, datë 18.10.2023, neni 21, paragrafi 2, përcaktohet se një nga dokumentet e kërkuara për licencimin specialistik është licenca e doktorit të stomatologjisë.

III. Sistemi i kodifikimit në licencat e anëtarit të OSK-së

- Parashtesa "KO" ndjeket nga numri serik të licencës së anëtarit.
- Kodi "02" i vendosur pas numrit serik është kodi identifikues i profesionit bazë "Doktor i Stomatologjisë" (për ilustrim: 01 përdoret për mjekësi, 03 për farmaci).
- Pas "02" vendoset kodi identifikues i profilit/specializimit në stomatologji, i cili ndryshon sipas profilit të anëtarit (p.sh. 37, 39, 40, 41, 42, 43, 49, etj.).
- Në këtë mënyrë, licenca specialistike nuk e shfuqizon licencën bazë të doktorit të stomatologjisë, por i shtohet asaj si shënim/profil me kod përkatës specialistik.

IV. Analiza juridike e kodit të licencës së doktorit të stomatologjisë

1. Numri pesëshifror që ndodhet pas parashtesës KO përbën numrin serik të licencës, ndërsa kodi 02 i vendosur pas numrit serik është kod identifikues i cili jepet vetëm doktorëve të stomatologjisë (për doktorët e mjekësisë kodi është 01, ndërsa magjistrat e farmacisë kodi është 03). Ndërsa kodi identifikues që pason kodin 02, është kod identifikues për fushën e caktuar të specializimit stomatologjik, dhe ky kod mund të ndryshojë te anëtarët në vartësi nga profili specialistik i tyre (p.sh 37, 39, 40, 41, 42, 43, 49).
2. Nga aktet e lartpërmendura rrjedh qartë se e drejta për specializim presupozon domosdoshmërisht licencën bazë "Doktor i Stomatologjisë". Vetë fakti që OSK lëshon kod "02" për profesionin bazë (doktor i stomatologjisë) dhe më pas shton kodin e profilit specialistik, tregon se specializimi është kualifikim shtesë mbi profesionin bazë, jo status i veçuar apo zëvendësues (shfuqizues i licencës si Doktor i Stomatologjisë)
3. Në aspektin administrativ dhe të punësimit publik:
 - Kriteri minimal për pozitën "Doktor i Stomatologjisë" në QKMF është pikërisht licenca bazë (kodi 02). Kandidati që mban edhe kodin e profilit specialistik e plotëson këtë kriter, sepse ai/ajo posedon njëkohësisht licencën bazë.
 - Nuk ekziston ndonjë ndalim ligjor që një profesionist me profil specialistik të mos mund të ushtrojë detyrat e profesionit bazë-doktor i stomatologjisë. Përkundrazi, nga

UA 01/2023 dhe Rregullorja e OSK-së del se specializimi është i varur nga licenca bazë.

- Përfundim mund të ketë vetëm kur pozita shpallet shprehimisht si pozicion specialistik me profil të përcaktuar (p.sh., kërkohet kod-profil i caktuar) – rast në të cilin kriteri shtohet, nuk zvogëlohet. Por, në pozitën “Doktor i Stomatologjisë”, përfundimi i specialistëve vetëm pse janë specialistë do të ishte pa mbështetje ligjore dhe i papajtueshëm me parimin e trajtimit të barabartë dhe të meritës në rekrutimin publik.

V. Përfundimet dhe konstatimet

1. Dokumentet e identifikimit të OSK-së pasqyrojnë qartësisht dy nivele kodi:
 - “02” = profesioni bazë “Doktor i Stomatologjisë”;
 - Kodi vijues = profili/specializimi (kualifikim shtesë).
2. Posedimi i kodit “02” nga çdo anëtar – përfshirë ata me profil specialistik – legjitimon të drejtën për të konkurruar në pozitën “Doktor i Stomatologjisë”.
3. Institucionet punëdhënëse mund të kërkojnë profil të caktuar vetëm kur pozita është shpallur si specialistike dhe arsyëzohet objektivisht me nevojat e shërbimit (p.sh. profil kirurgji orale, endodonci, pedodonci). Në secilin rast tjetër, trajtim i barabartë për të gjithë bartësit e kodit 02, është i siguar me legjislacionin aktual.
4. Asnjë nga bazat ligjore të lartëcekura, nuk përcaktojnë se licencimi si profesionistë shëndetësorë në profile specialistike nënkupton shfuqizim të licencës si doktor i përgjithshëm.
5. Refuzimi i aplikimeve të specialistëve thjesht për shkak të statusit të tyre specialistik, kur kriteri i shpalljes është vetëm licenca bazë e doktorit të stomatologjisë, është i pajustifikuar juridikisht dhe diskriminues.

Vërejtje: Opinioni i dhënë nga Oda e Stomatologëve të Kosovës përkthet me këtë çështje nuk ka fuqi detyruese, por ka për qëllim sqarimin e dispozitave ligjore të lartëcekura.

Zyra ligjore e OSK-së

Taulant Bajrami

